



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 5-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 27.05.2022, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës
2. Valon Pacolli, DEZH
3. Shkelzen Hajdini, DSH

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë, po ashtu tha e kemi edhe një pikë shtesë nga drejtorati për shëndetësi dhe nëse pajtoheni edhe ju po e fus ne rend te ditës, pastaj të njëjtin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 4-të e KPF-së.
2. Propozim Vendim për miratimin e Planit vjetor të punës së KKSB-së për vitin 2022.
3. Propozimi Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB-së.

4. Propozim Vendim për fillimin e procedurave për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në ZK Qylagë - faza e parë.
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në Qylagë - faza e parë.
6. Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të subjekteve afariste në zonën ekonomike “Parku Industrial” në Qylagë.
7. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
8. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.
9. Propozim vendim për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit mbi përfshirjen sociale në komunën e Lipjanit 2022-2024

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreh rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat, 7 për, aprovoi rendin e ditës:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 4-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 4-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

II

Propozim Vendim për miratimin e Planit vjetor të punës së KKSB-së për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën Lulzim Qerimit, nënkryetar i komunës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Arsim Jashari, tha se nëse kemi ndonjëherë ndonjë pyetje për anëtarët e KKSB-së, a mund të vijnë këta në kuvend me raportua.

Daut Azemi, tha se po këta sa here që ti ftojme mund të vijnë në kuvend, por edhe në fund të vitit do të raportojnë për punën e kuvendit.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

III

Propozimi Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB-së.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën Lulzim Qerimit, nënkryetar i komunës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim Vendim për fillimin e procedurave për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në ZK Qylagë - faza e parë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, DKZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se kriteret për aplikim ipen nga Ministria e Tregtisë, a po? Kam një propozim që kur të vendoset kriter edhe kriteri i mbrojtës ekologjike, dhe mos të preket shëndeti publik.

Arsim Jashari, tha se është mirë të përcjellët procesi i punës dhe mos të ketë manipulime. Pasi që me herët kur janë dhënë disa prona në shfrytëzim nuk është që ju kanë përmbajtur kriteret. Çmimi si do të caktohet?

Valon Pacolli, tha se çmimin e kemi menduar në fillim për 3 vitet e para pa pagesë ndërsa në vitet në vijim me filluar me një çmim simbolik.

Fitim Shala, nëse gjatë këtyre 3 viteve dështon biznesi si do të veprohet.

Valon Pacolli, tha se nuk e di se kemi menduar këtë.

Alban Salihu, si do të jetë çmimi pas 3 viteve, si do të veprohet pas kësaj kohe. Edhe të këto zonat ekonomike nuk është që kanë qenë aq të suksesshme.

Daut Azemi, tha se si kuvend po e caktojmë deri në 3 vite, pastaj ndër kohe e shohim si do të veprojmë.

Mëqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi të procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "Parku Industrial" në Qylagë - faza e parë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të subjekteve afariste në zonën ekonomike "Parku Industrial" në Qylagë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacollit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacollit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se do te ishte mirë qe çmimi te jetë 2 euro për metër.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VIII

Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i a dha fjalën, Valon Pacollit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IX

Propozim vendim për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit mbi përfshirjen sociale në komunën e Lipjanit 2022-2024

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i a dha fjalën, Shkelzen Hajdini, drejtor i DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se kur pritet me filluar me u zbatuar kjo strategji?

Shkelzen Hajdini, tha se në këtë strategji është filluar të punohet në vitin 2020, pritet me filluar shumë shpejte por sa do të zbatohet në praktike as unë nuk e di?

Egzona Bytyqi, tha se me gëzon fakti që po bëhet një strategji e tillë, dhe shpresoj që me këtë strategji disa kategori do të përfshihen me mire.

Shkelzen Hajdini, tha se është një strategji shumë e mirë, për të mirën e qytetarëve.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:10

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi